



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË - DEGA E GJYKATËS FUSHË KOSOVË

Numri i lëndës: 2020:054756

Datë: 05.12.2023

Numri i dokumentit: 05011434

C.nr.2368/20

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË – DEGA NË FUSHË KOSOVË, Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil, me gjyqtaren Qëndresa Beqiri Murati, në çështjen juridike kontestimore të paditëses “B...”, me seli në Prishtinë, magjistrerja Prishtinë-Fushë Kosovë, e cila sipas autorizimit përfaqësohet nga “V...” Sh.P.K me seli në Fushë Kosovë, kundër të paditurit B. G nga Fushë Kosova, me objekt të padisë rimbursimin e dëmit, vlera e objektit të kontestit 1,379.00 euro, me datë 21.11.2023 mbajti seancën e shqyrtimit kryesor publik në prani të përfaqësuesit sipas autorizimit të paditëses, kurse me datë 04.12.2023 mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET NË TËRËSI E BAZUAR kërkesëpadia e paditëses “B...”, me seli në Prishtinë, ashtu që DETYROHET i padituri B. G nga Fushë Kosova, që paditëses t’ia kompensojë shumën prej 1,379.00 euro në emër të rimbursimit të dëmit të shkaktuar në aksidentin e trafikut të datës 13.07.2018, i ndodhur në Fushë Kosovë, me kamatë e cila vlen si për mjetet e deponuara në bankat që operojnë në Kosovë, në afat më tepër se një vit pa destinim të caktuar, duke llogaritur nga dita e parashtrimit të padisë në gjykatë (datë 10.05.2020), e deri në përmbushjen e tërësishme, të gjitha në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të Aktgjykimit;
- II. DETYROHET i padituri B. G nga Fushë Kosova, që paditëses “B...”, me seli në Prishtinë t’ia paguaj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 30.00 euro.

A r s y e t i m

Paditësja “B...”, me seli në Prishtinë, me datë 20.05.2020, pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë, ka parashtruar padi kundër të paditurit B. G nga Fushë Kosova. Në padi ndër të tjera ka theksuar se i padituri me datë 13.07.2018, rreth orës 19:57, me motoçikletën e tipit S..., ka shkaktuar aksident trafiku në Fushë Kosovë, me ç ‘rast i ka shkaktuar dëme materiale dhe jomateriale të dëmtuarit F. A. Tutje në padi ka theksuar se mjeti me të cilin është shkaktuar ky aksident, në kohën e ndodhjes së aksidentit ka qenë pa mbulesë siguroese. Ndërsa si rezultat i saj, paditësja të dëmtuarit F. A konform Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia, ia ka kompensuar dëmin material dhe jomaterial të shkaktuar në këtë aksident.

Në fund nga gjykata ka kërkuar që padinë e paditëses ta aprovoj në tërësi të bazuar, dhe të detyrohet i padituri B. G që në emër të rimbursimit të dëmit material dhe jomaterial të shkaktuar në aksidentin e trafikut, paditëses t'ia paguaj shumën prej 1,379.00 euro, me kamatë ligjore nga dita e parashtrimit të padisë e deri në pagesën definitive.

I padituri B. G pranë gjykatës me datë 15.08.2023, ka parashtruar përgjigje në padi, ku ndër të tjera ka theksuar se padia e paditëses nuk i përmban të gjitha elementet e parapara për të gjykuar në mënyrë meritore, ndërsa këto mangësi kanë të bëjnë me mungesën e kërkesës së caktuar në pikëpamje të çështjes kryesore e cila ka të bëjë me detyrimin e palës së paditur, dhe se padia e paditëses nuk është e precizuar me prova mjekësore, fatura reale dhe nuk mund të kuptohet saktësisht detyrimi i palës së paditur për format e dëmit material. Tutje ka theksuar se nga raportet mjekësore nuk mund të konstatohet se çfarë lëndime ka pësuar i dëmtuari F. A, ndërsa nga aksidenti i policisë nuk mund të konstatohet se kush ka qenë fajtor me rastin e shkakimit të aksidentit. Në fund i ka kërkuar gjykatës që padinë e paditëses ta refuzoj si të pabazuar. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

Me qëllim të procedimit në lidhje me këtë çështje kontestimore, gjykata dy herë ka provuar që të paditurit t'ia dorëzoj ftesën për seancën përgatitore dhe atë një herë në adresën Fushë Kosovë, adresë kjo në të cilën i padituri e ka pranuar aktvendimin për përgjigje në padi, si dhe në adresën e dhënë në përgjigjen në padi, rruga "...", nr. ,por që fletë-kthesat e gjykatës të datës 07.09.2023 dhe 26.10.2023 janë kthye me konstatimin e fletëdorëzuesit, se pala është larguar, respektivisht pala e panjohur në këtë adresë.

Pasi që gjykata nuk ka pasur mundësi që palës së paditur t'ia dërgoj ftesën për seancë gjyqësore, në kuptim të dispozitës së nenit 116 paragrafi 1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, e cila ka paraparë detyrimin e palës që të informojë gjykatën për ndërrimin e adresës ku i janë dërguar shkresat e gjykatës, vendosi që konform nenit 116 paragrafi 5 dhe 6, të paditurit komunikimi i shkresave t'i bëhet përmes afishimit të tyre në tabelën e shpalljeve në gjykate.

Gjykata ka caktuar dhe mbajtur seancë gjyqësore me datë 21.11.2023, në prezencë të palës paditëse, e në mungesë të palës së paditur, të ftuar në mënyrë të rregullt, përmes afishimit të ftesës për në seancë në tabelën e shpalljeve të gjykatës.

Paditësja në seancë gjyqësore dhe në fjalë përfundimtare ka deklaruar se mbeten në tërësi pranë padisë dhe kërkesës së saj, duke theksuar se i padituri ka shkaktuar aksidentin e trafikut të datës 13.07.2018. Tutje ka theksuar se në momentin e aksidentit i padituri nuk ka pasur polisë të sigurimit, tabela të regjistrimit, dhe i njëjti ka qenë pa patentë shofer.

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, në seancën e shqyrtimit kryesor, sipas propozimit të palës paditëse, gjykata ka administruar provat në vijim: Raporti policor me numër... i datës 13.07.2018; Urdhërtransferi i datës 24.09.2019; Ujdia jashtëgjyqësore e datës 12.09.2019; Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Divizioni Penal me numër P.nr 3855/2018 i datës 16.11.2018, si dhe Raportet mjekësore të Qendrës Emergjente të QKUK-së.

Pasi që gjykata bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjithave së bashku, mbështetur në dispozitat e nenit 8 të LPK-së, e aprovoi në tërësi kërkesëpadinë e paditëses dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, nga arsyet në vijim.

Kështu, në mes palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestues fakti se me datë 13.07.2018, në Fushë Kosovë, ka ndodhur aksidenti i komunikacionit, ndërmjet një motoçiklete e tipit S..., pa targa të regjistrimit dhe pa policë valide të sigurimit, e cila drejtohej nga B. G, dhe këmbësorit, këtu palës së dëmtuar F. A. Kontestues ishte fati i përgjegjësive së palës së paditur në lidhje me aksidentin e shkaktuar, si dhe lartësia e dëmit material të shkaktuar.

Nga provat e administruara në shqyrtim gjyqësor, gjykata ka vërtetuar faktin se i padituri ka qenë pjesëmarrës në komunikacion, me ç'rast është shkaktuar aksidenti, e që fajtor në këtë aksident është i padituri B. G, fakt i vërtetuar përmes raportit të policisë, të datës 13.07.2018, me numër..., si dhe Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë - Divizioni Penal me numër P.nr 3855/2018 i datës 16.11.2018, me të cilin i padituri B. G ishte shpallur fajtor për veprën penale Rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 paragrafi 6 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së.

Përmes ujdisë jashtëgjyqësore të datë 12.09.2019, të lidhur në mes të paditëses dhe palës së dëmtuar F. A nga komuna e Skenderajt, me të autorizuarin e tij N. S avokat në Prishtinë, vërtetohet fakti se është arritur marrëveshje që pala e dëmtuar në aksident të kompensohet në shumë prej totale prej 1,379.00 euro. Kurse nga Urdhërtransferi i datës 24.09.2019, gjykata gjeti se më datë 24.09.2019, është dhënë urdhër për transferimin e mjeteve tek i autorizuari i të dëmtuarit avokat N. S (për F. A), në shumën prej 1,379.00 euro. Faktet se mjetin që ka shkaktuar aksidentin ka qenë duke e vozitur i padituri vërtetohet përmes Raportit... të Policisë së Kosovës të datës 13.07.2018. Po nga ky raport vërtetohet edhe fakti se motoçikleta të cilën ishte duke e vozitur shkaktari i aksidentit, këtu i padituri B. G, nuk kishte polisë të sigurimit nga autopërgjegjësia dhe as tabela të regjistrimit.

Në lidhje me përgjegjësinë e të paditurit për aksidentin e shkaktuar me datë 13.07.2018, gjykata nga aktgjykimi me numër P.nr. 3855/2018 i Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Penal, gjeti se i padituri B. G, me datë 16.11.2018, i plotëfuqishëm nga data 14.03.2019, ishte shpallur fajtor në lidhje me veprën penale Rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 paragrafi 6 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së, pikërisht për aksidentin e shkaktuar, e për të cilin paditësja në këtë procedurë kërkon regres nga i padituri. Neni 321 paragrafi 1 i Ligjit për Procedurën Kontestimore, ka përcaktuar se *“Nuk ka nevojë të provohen faktet e ditura botërisht e as faktet që i ka vërtetuar gjykata në gjykimet e mëhershme”*, në këtë kuptim, përgjegjësinë e të paditurit në lidhje me aksidentin e shkaktuar e ka vërtetuar gjykata në aktgjykimin e lartcekur.

Në kuptim të nenit 18, paragrafi 4 të Ligjit nr. 04/L-018 për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia përcaktohet se *“Byroja ka të drejtë regresi për këto dëme nga personi përgjegjës dhe atë për shumën e paguar, shpenzimet dhe kamatat”*.

Ndërsa neni 245 i Ligjit nr. 04/L-077 mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve ka përcaktuar se *“Kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit,*

ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbushë atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij". Duke qenë se në këtë rast kontestues, është vërtetuar se ekziston dëmi që debitori i ka kreditorit, kjo normë tërheq pas vetes të drejtën e paditëses të kërkojë atë, kurse detyrimin e të paditurit të përmbushë.

Gjykata ka vlerësuar edhe pretendimet e të paditurit të dhëna në përgjigje në padi, sa i përket konstatimit të lëndimeve të palës së dëmtuar, si dhe përgjegjësesë së të paditurit në lidhje me shkaktimin e aksidentit, por që nga arsyet e cekura më lart të njëjtat nuk patën ndikim në vendosjen ndryshe të kësaj çështje

Duke qenë se pas administrimit të të gjitha provave, gjykata ka aprovuar kërkesëpadinë, po ashtu ka vërtetuar se paditësit i takon edhe kamatëvonesa, lartësinë e të cilës e ka përcaktuar sipas mjeteve të deponuara në bankat afariste mbi një vit pa destinim të caktuar, pasi që ashtu ka qenë kërkesa nga pala paditëse, dhe gjykata vendosë vetëm brenda kufijve të kërkesave të palëve, sipas nenit 2, paragrafi 1 të LPK-së.

Vendimin lidhur me shpenzimet e procedurës kontestimore, si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, Gjykata e mbështeti në dispozitën nga neni 452 paragrafi 1 lidhur me nenin 463 paragrafi 1 LPK-së, duke e obliguar të paditurin që paditëses sipas kërkesës së specifikuar t'ia kompensojë shumën e tërësishme të shpenzimeve në vlerë prej 30.00 euro.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË - DEGA NË FUSHË KOSOVË
Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil
C.nr.2368/20, datë 04.12.2023

Gjyqtarja
Qëndresa Beqiri Murati

KËSHILLË JURIDIKE: *Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së te njëjtit, Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.*